



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04/IA005

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 6 maj 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

### Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së Pjetër Shalës:**

Zhan Lui Zhilisen

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke marrë parasysht nenet 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullat 58(1), (2), 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me “Apelin e Mbrojtjes kundër Vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës të datës 22 prill 2022,” (“Apeli”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim me anë të së cilit urdhëronte vazhdimin e paraburgimit të z. Pjetër Shala (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>2</sup>

2. Më 4 maj 2022, z. Shala dorëzoi Apelin.

## II. KLASIFIKIMI

3. Apeli është klasifikuar si konfidencial dhe për rrjedhojë dhe ky vendim do të mbajë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë.

## III. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe

---

<sup>1</sup> IA005/F00001, Apeli i Mbrojtjes kundër Vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës të datës 22 prill 2022, 4 maj 2022 (konfidencial).

<sup>2</sup> F00188/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Pjetër Shalës, 28 prill 2022 (versioni origjinal konfidencial u dorëzua me 22 prill 2022), para. 59.

disponueshmërinë në këtë moment,

**KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Kai Ambos**

**Gjykatësen Nina Jorgensen**

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me Apelin.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 6 maj 2022  
Hagë,  
Holandë